

Syllabusi i lëndës

Lënda: Bazat e Komunikimit - *Komunikologjia*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 3

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 406

Fondi i orëve: 2+0

Viti akademik: 2026-2027

Semestri: VII

Mësimdhënësi: Prof.Ass.Dr. Rexhep Suma

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Kursi në fushën e komunikimit, do përfshijë një qasje dhe metodologji tipike: funksionaliste e strukturaliste të komunikimit në sidomos periudhën e revolucionit të teknologjisë informative. Moduli, do i adresohet kryesisht termave dhe çështjeve që kanë të bëjnë me natyrën e komunikimit në media, dhe si i tillë do të ndjek të arriturat më të reja në sferën e komunikimit bashkëkohore dhe kërkimeve të ngjashme në këtë fushë, sfera e komunikimit politik ne media, si një teknologji dhe shkencë në vete që përmban koncepte bazë, përkufizime dhe aplikimet kërkimore të teorive të shekullit tonë i gjithë moduli, është i paraparë që zhvillohet përmes: komenteve kritike, hulumtimeve dhe debateve.

Qëllimi i lëndës

Kjo lëndë do tu ndihmoj studentëve të ndërtojnë, ngritin dhe testojnë vlerat e tyre në komunikim, si dhe të stimuloj mendimin kritik me qëllim të diskutimit të tema të ndryshme kontroverse në botën e medieve në raport me shkencat e komunikimit

- Ky kurs është një kurs i ri në fushën e komunikimit në media, që do përfshijë një qasje dhe metodologji tipike: funksionaliste e strukturaliste të komunikimit në sidomos periudhe e revolucionit të teknologjisë informative. Moduli, do i adresohet kryesisht termave dhe çështjeve që kanë të bëjnë me bazat e komunikimit në media.

- Qëllimet e kursit janë që fitohen njohuri dhe dije të reja nga sfera e komunikimit politik ne media, si një teknologji dhe shkencë në vete që përmban koncepte bazë, përkufizime dhe aplikimet kërkimore të teorive të shekullit tonë. Kjo lëndë është një hyrje në shkencën e medieve dhe komunikimit, si dy pjesë përbërëse dhe të pandashme në botës mediale. Lënda është dizajnuar në atë

<p>mënyrë që t'ju pajisë me pjesën teorike dhe analitike të shkencës së medieeve dhe komunikimit si dhe të arriturave shkencore në botën e komunikimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmes kombinimit të ligjëratave dhe detyrave do të kuptoni për zhvillimin e medieeve nëpër etapa të ndryshme kohore dhe mësoni për metodat e komunikimit dhe rëndësinë e tyre në punë e në jetë. - Ligjëratat do të fokusohen në shkencat e komunikimit dhe shkencën e medias. Fillimisht do të njohim nocionin komunikim dhe lidhshmërinë e tij me semiologjinë, pastaj me mjetet e komunikimit, rëndësinë e kësaj shkencë në ekzistencën njerëzore. - Më pastaj ligjëratat do të ve në pah teoritë e ndryshme të komunikimit dhe rëndësinë e komunikimit masiv. - Po ashtu do të thellohemi në rëndësinë njohjes së bindjes së masave përmes komunikimit si mjete shumë të rëndësishme në jetë. <p>- .</p>
--

Rezultatet e pritura të nxënies:

<p>Në përfundim të këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje:</p> <p>Përmes mësimin dhe studimit të lëndës "Bazat e Komunikimit" studenti mund të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> * Identifikon termat kryesor dallues: nocionin komunikim dhe lidhshmërinë e tij me semiologjinë, Komunikimin global, revolucion teknologjik, globalizëm, rend i ri botëror, integritet, teoritë e ndryshme të komunikimit dhe rëndësinë e komunikimit masiv etj *Përshkruan proceset e komunikimit botëror, si edhe rirreshtimin: teknologjik, social, kulturor, ekonomik e kulturor. * Harton dhe projektton objektivat e mundshme të proceseve globale të komunikimit në media, si edhe procesin e transformimit apo akomodimit të tyre me trendet aktuale globale. *Gjykon dhe kupton koherencën e zhvillimeve dhe proceseve në mënyrë të pavarur. <p>- .</p>

Metodologjia e mësimdhënies:

<p>Realizimi i mësimdhënies do të zhvillohet nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve nga lëmi i "Bazat e komunikimit". Në këtë kontekst, si forma të punës në interpretimin e përmbajtjeve të veprave do të jenë ligjëratat e rregullta, esetë, ushtrimet, diskutimet, puna në grupe dhe, për të gjitha këto, do të përdoren teknika dhe metodat e reja. Natyra e lëndës mundëson shumëllojshmëri qasjesh të mësimdhënies dhe strategjive të mësimdhënies. Nga ju kërkohet reflektim kritik dhe qasje reflektive për të zhvilluar të menduarit kritik. Çdo formë e paraqitur është e hapur për diskutim dhe modifikim përmes dakordimit të përbashkët.</p> <p>- Ligjëratat - Ligjëratat mbahen sipas orarit të publikuar në web faqe, www.fsi-edu.net. Inkurajoheni</p>
--

të jeni sa më aktiv dhe fleksibil si dhe të përfshirë në të gjitha detyrat që realizohen në klasë.

- **Ushtrimet praktike** – Pjesa e praktikës do të jetë demonstrim i njohurive dhe shkathtësive të përfituara në ligjëratë si dhe me hulumtimin që përcaktohet nga profesori dhe studenti paraprakisht në funksion të temës.
- **Punë individuale dhe detyra** - Gjatë realizimit të mësimit do të keni edhe detyra individuale për të përmbushur obligimet. Detyrat mund të përzgjedhë nga:
- Plani i orës i përgatitur për të mbajtur orën praktike.

Përmbajtja e lëndës:

Nr.	Java	Ligjërata
1.	Java I	Prezantim i përgjithshëm i përmbajtjen e syllabusit dhe çështjeve që ndërlidhën me përmbajtjes së lëndës.
2.	Java II	Hyrje në shkencat e komunikimit.
3.	Java III	Gjuha si mjetë i komunikimi masiv dhe simbol në perspektivë krahasuese
4.	Java IV	Perspektiva e komunikimit masiv.
5.	Java V	Mediumi është mesazhi
6.	Java VI	Përcaktimi dhe definimi i shtypit islam
7.	Java VII	Kollekfiumi I
8.	Java VIII	Globalizimi kulturor dhe komunikimi global
9.	Java IX	Komunikimi masiv si hapësirë publike
10.	Java X	Politika e mediave dhe etika e medieve
11.	Java XI	Mediat islame, objektivat dhe specifikat
12.	Java XII	Efektet sociale të komunikimit masiv
13.	Java XIII	Interneti dhe teknologjitë e reja të informacionit
14.	Java XIV	Mediat dhe shoqëria
15.	Java XV	Rezyme e lëndës
Provimi përfundimtar		

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti duhet të respektojë institucionin dhe rregullat e përcaktuara, duke përfshirë:

- Respektimin e orarit të ligjëratave.
- Mbajtjen e disiplinës dhe të qetësisë gjatë ligjëratave.
- Pasimin e udhëzimeve të mësimeve.
- Ndalimin e përdorimit të celularëve apo pajisjeve të tjera gjatë orëve të mësimit.

Literatura obliguese:

1. Ligjëratat përgatitura nga profesori i lëndës, Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma.

2. Ronald B. Adler, George Rodman, Athena du Pre, Hyrje në komunikim, UETpress, Tiranë, 2023.

3. Rexhep Suma, Islami dhe Identiteti, Logos-A, 2020.

4. Hatice Aydoğan, Amësia digjitale, Logos-A, Shkup, 2023.

5. Geraldine Muhlmann, Gazetaria në demokraci, Zenit, Tiranë, 2021.

6. Rexhep Suma, Reflektim mendimesh në da've, FSI, 2018.

7. Artan Fuga, Komunikimi në shoqërinë masive, Papirus, Tiranë, 2014.

8. Aleksandër Dh. Dhima, Antropologjia e Komunikimit, Tiranë, 2013.

Kontributi në ngarkesën e studentit

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktime me mësimdhënësin\konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren	-	-	-
Kollokfiume, seminare, ese	1	10	10
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim.	5	4	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, ese, provim final)	2	5	10
Totali	13	15 javë	125